



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**Komisioni Vlerësues** (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01-011/01-16241 të datës 02.04.2026, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenin 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, me qëllim të zbatimit të vendimit paraprak me numër 01-011/01-16239 të datës 02.04.2026, të miratuar nga Kuvendi Komunal për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, në mbledhjen e mbajtur me datën 19.06.2026 merr vendim për shpalljen e:

**NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK  
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË  
PALUAJTSHME KOMUNALE - PARKINGU**

Me të cilin ftohen të gjithë të interesuarit, që të shfrytëzojnë të drejtën e marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale:

- 1. Prona e paluajtshme për dhënien në shfrytëzim gjendet:** në zonën kadastrale Gjakovë Qytet, e evidentuar me numër kadastral të ngastrës: P-70705029-05765-1, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1121m<sup>2</sup>.
- 2. Afati për dhënien në shfrytëzim të pronës:**  
Afati për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale do të jetë afatshkurtër, deri në dy (2) viteve.

**Qëllimi:**

**Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatshkurtër është:**

1. Funksionalizimi i parkingut;
2. Përfitimi ekonomik i komunës përmes qiradhënies.

**Kushtet e veçanta:**

- a) Çmimi fillestar për dhënien në shfrytëzim të parkingut është 900€, në emër të qirasë mujore;
- b) Përzgjidhet oferta me çmimin me të lartë të ofruar në ankand;
- c) Aktiviteti kryesor i biznesit i vitit paraprak, duhet të jetë në fushën e transportit;

- d) Në rast se në ankand ofrohen dy apo me tepër çmime me të larta dhe të njëjtat, atëherë përfituesi caktohet me short ndërmjet këtyre ofertave, në prani të tyre dhe të Komisionit Vlerësues.

**Kushtet e përgjithshme të ankandit publik:**

1. Afati për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale do të jetë afatshkurtër, deri në dy (2) vite.
2. Ofertës duhet bashkangjitur këto dokumentacione:
  - **Certifikata e regjistrimit të biznesit së bashku me informacionet mbi biznesin;**
  - **Vërtetimin e ATK-së mbi kryerjen e obligimeve tatimore;**
  - **Vërtetimin e tatimit në pronë (të pronarit të biznesit, që nuk ka detyrime të papaguara);**
  - **Lista e punëtoreve të vitit paraprak;**
  - **Vërtetimi i Sektori për Menaxhimin e Pronës Komunale që nuk kanë obligime të papaguara të shfrytëzimit të pronës komunale;**
  - **Vërtetimin e taksës në firmë si dhe**
  - **Dokumenti që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, për përfaqësuesin e biznesit dhe pronarin e biznesit, jo më e vjetër se 6 muaj).**
3. Ofertuesit që nuk i bashkëngjisin të gjitha dokumentet e nevojshme, diskualifikohen dhe oferta e tyre nuk do të shqyrtohet fare.
4. Shfrytëzimi i pronës mund të bëhet vetëm sipas destinimit të cilin e ka – parking.
5. Veturat zyrtare të institucioneve komunale, lirohen nga pagesa për shfrytëzimin e parkingut.
6. Shfrytëzuesi i pronës komunale obligohet që të vendosë pajisje të komunikacionit për parking sipas kërkesës së Drejtorisë së Infrastrukturës – Sektori i Komunikacionit.
7. Shfrytëzuesi i pronës obligohet që të rezervojë dhe të vendos shenjat e komunikacionit për dy vend parkingje për veturat e personave me nevoja të veçanta, si dhe të lirojë nga pagesa për këto dy vend parkingje.
8. Çmimet për vend parking për vetura, nuk mund të jenë më të larta për orë ose muaj qëndrimi, se sa janë të planifikuar në Rregulloren për Taksa Komunale.
9. Komuna për interes të përgjithshëm në zbatim të projekteve në prona publike rezervon të drejtën të realizojë punime pa u penguar nga shfrytëzuesi.
10. Pagesat dhe obligimet e të gjitha komunalive në parking barten tek shfrytëzuesi nga koha e nënshkrimit të kontratës.

